



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 201, Datë 12.12.2019

MBI

**LËNIEN NË FUQI TË VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-S NR. 8, DATË 17.01.2019 “MBI
ÇMIMIN VJETOR TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, QË DO T’U PAGUHET
PRODHUESVE EKZISTUES ME PËRPARËSI TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR
VITIN 2019”.**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 10 të Ligjit nr.7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 687, datë 22.11.2017 “Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve egzistues me përparësi”, nenit 15, nenit 21 dhe nenit 22 të “Rregullores për organizimin funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 12.12.2019, pasi shqyrtoi relacionin nr. 114/7 Prot., datë 10.12.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, në lidhje me lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 8, datë 17.01.2019 “Mbi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi të energjisë elektrike për vitin 2019”,

Konstatoi:

- ERE në bazë të nenit 10 të Ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, është autoriteti përgjegjës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike nga burimet hidrike, në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Këshilli i Ministrave.
- Këshilli i Ministrave me Vendimin nr. 687, datë 22.11.2017, ka miratuar “Metodologjinë e përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”.
- Formula për llogaritjen e këtij çmimi, sipas metodologjisë të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 687, datë 22.11.2017ë lartpërmendur, është “Çmimi vjetor i blerjes (Lekë/kWh) = Çmimi mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) i energjisë elektrike në profilin bandë (baseload) i vitit përkatës të bursës hungareze (HUPX) të energjisë elektrike në euro cent/kWh X bonusin për promovimin e burimeve të rinovueshme në masën 1.3 X normën mesatare të këmbimit në Euro/Lekë për vitin e fundit”.

- Nga të dhënat paraprake të marra nga faqja e internetit të Bursës Hungareze të Energjisë (<https://hupx.hu/en/market-data/dam/regular-reports>), është marrë çmimi i deritanishëm mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) të energjisë elektrike në profilin bandë (baseload) për vitin 2019, i cili rezulton të jetë në vlerën 51.15 Euro/MWh.
- Sipas “*Metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi*”, me normë mesatare të shkëmbimit të vitit të fundit, kuptohet kursi mesatar vjetor i këmbimit Euro/Lekë, i publikuar nga Banka e Shqipërisë për vitin 2019. Nga të dhënat e deritanishme të publikuara nga Banka e Shqipërisë mbi kursin e këmbimit, rezulton se kursi mesatar i këmbimit për 11 muajt tashmë të mbyllur të vitit 2019 (Janar - Nëntor) është 123.09 Lekë/Euro.
- Kufijtë minimalë dhe maksimalë të çmimit të blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi, përcaktohen sipas gërmave “ç” dhe “d” të pikës 2 të VKM nr. 687, datë 22.11.2017, ku kufiri minimal është çmimi i miratuar nga ERE për vitin 2016 për këta prodhues (çmim dysHEME) dhe ai maksimal është 15% më i lartë se çmimi i miratuar nga ERE për vitin 2016 për këta prodhues (çmim tavan).
- Për sa kohë nuk është mbyllur viti ushtrimor 2019, deri në publikimin e raportit vjetor të bursës Hungareze të energjisë (HUPX), si dhe raportit vjetor të Bankës së Shqipërisë, formula sipas metodologjisë së miratuar me VKM nr.687, date 22/11/2017, nuk mundëson korrigjimin e komponentëve të formulës së paraqitur sa më sipër.
- Me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 8, datë 17.01.2019, është miratuar çmimi vjetor i blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi të energjisë elektrike për vitin 2019, i cili bazuar në “Metodologjinë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi” miratuar me VKM nr. 687, datë 22.11.2017, ka rezultuar të jetë 8.4582 Lekë/kWh.
- Duke qenë se, raporti vjetor i Bursës Hungareze të Energjisë (HUPX) dhe i Bankës së Shqipërisë, publikohet në fillimin e vitit pasardhës, do të ishte e nevojshme, lënia në fuqi e vendimit të bordit të ERE Nr. 8, datë 17.01.2019 “Mbi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi të energjisë elektrike për vitin 2019”.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s Nr. 8, datë 17.01.2019, “Mbi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi të energjisë elektrike për vitin 2019”, deri në miratimin e një çmimi nga ERE, mbështetur në publikimin e raportit vjetor të Bursës Hungareze të Energjisë (HUPX), si dhe publikimet e Bankës së Shqipërisë për kursin e këmbimit Lekë/EUR.

2. Ngarkohet Drejtoria e Çështjeve Ligjore, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI